



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____. 2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 11 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1462 prot., datë 05.03.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 të Kushtetutës së Republikës, është organi kushtetues që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. I veshur me kompetenca të tilla kushtetuese, ligji nr. 115/2016 “Për organet e sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 87 të tij, ka parashikuar mundësinë e Këshillit që të bëjë deklarata publike në mbrojtje të gjyqtarëve të veçantë kur gjykon se të drejtat e tyre njerëzore rrezikohen të shkelen për shkak të kryerjes së detyrës, ose se kryerja e funksioneve të tyre ligjore po rrezikohet ose mund të rrezikohet si rezultat i veprimeve ose qëndrimeve të çdo subjekti publik ose privat.

Në përputhje me këto parashikime, në situatën e deklarimeve publike të përsëritura në media, Këshilli më datë 04.03.2024 ka dalë me një reagim publik përmes të cilit ka dënuar sulmet ndaj gjyqtarëve dhe ka bërë thirrje palëve të respektojnë gjyqësorin si edhe të ndjekin mjetet ligjore për ankimin ndaj vendimeve gjyësore.

KLJGJ ka bërë reagime të tilla në të gjitha rastet në të cilat ka konstatuar se deklarime të tilla publike në media përbëjnë sulm ndaj gjyqtarëve për shkak të detyrës si edhe cënim të figurës dhe dinjitetit të tyre.

Në përgjigje të kërkesave tuaja, ju bëjmë po ashtu me dije se Këshilli në qëndrimin e tij publik, datë 04.03.2024 nuk ju është drejtuar përfaqësuesve konkret të medias dhe as ka ndërmarrë bërjen e përgënjeshtimeve. Këshilli në koherencë të qëndrimeve të mbajtura që nga krijimi i tij, ka bërë thirrje palëve të respektojë punën, figurën dhe dinjitetin e gjyqtarëve, si elementë të nevojshëm në forcim të shtetit të së drejtës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,